



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2630/8 prot.

Datë 05.12.2023

V E N D I M

Nr. 1258/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.12.2023 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Infosoft Systems” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-76141-07-26-2023 me objekt “Blerje pajisje Informatike (Kompjuter, Printer multifunksional, Printer termik, Printer traktor, Fotokopje A4 me ngjyra, Palmar, Monitor televizori, Barcod Reader)”, me fond limit 70,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.09.2023, nga autoriteti kontraktor Sh.A Posta Shqiptare.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomikë “BNT Elektronik” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Autoriteti Kontraktor:

Posta Shqiptare SH.A.
Adresa: Rr.“Reshit Çollaku”, Nr. 4 Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK me NIPT J61820021C dhe adresë: Rruga “Murat Toptani”, Gjergji Center, Tiranë.

Subjekte të Interesuar: Operatori ekonomik “BNT Elektronik” SHPK me NIPT J61817047D dhe adresë: Blv. “Zhan D’Ark”, Nd. Nr. 32, H. Nr. 16, Kati nr. 2, Ap. Nr. 1, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 27.07.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76141-07-26-2023 me objekt “Blerje pajisje Informatike (Kompjuter, Printer multifunksional, Printer termik, Printer traktor, Fotokopje A4 me ngjyra, Palmar, Monitor televizori, Barcod Reader)”, me fond limit 70,000,000.00 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 18.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Sh.A Posta Shqiptare.

II.2. Në datën 18.09.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 12.10.2023 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

“InfoSoft Systems” SHPK	53,087,960 lekë	Skualifikuar
“BNT ELECTRONICS” SHPK	56,360,900 lekë	Kualifikuar
“Atom” SHPK +”Erisony Company” SHPK	58,700,000 lekë	Skualifikuar
”Sinteza -CO” SHPK	62,873,500 lekë	Skualifikuar
“I.S.S” SHPK	69,360,000 lekë	Skualifikuar

II.4. Në datën 17.10.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim - Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt - ankimi, ku për këtë procedurë prokurimi është shpallur fituese oferta e operatorit ekonomik “BNT ELECTRONICS” SHPK.

II.5. Operatori ekonomik ankimues “Infosoft Systems” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë: “*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE në sistemin elektronik të APP-se, u konstatua se: Nuk i plotëson kriteret për kualifikim dhe konkretisht nuk plotësohet: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 1. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, duhet të plotësohet në çdo seksion të tij duke cituar edhe faqen e internetin apo burimin e dokumentit që vërteton që OE nuk është në kriteret për skualifikim. OE “Infosoft Systems” nuk e ka plotësuar Formularin e Vetëdeklarimit në mënyrën e kërkuar nga ligji, pasi nuk ka deklaruar në formular vetëdeklarimi, konkretisht në Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: Deklarata për Përmbushjen e Krieteve të Përgjithshme të Kualifikimit ortakun Tag Engineering ShPK, i cili sipas ekstraktit të QKB rezulton ortak me pjesëmarrje në 30%, nëse është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata. Rikujtojmë që personat juridike kanë përgjegjësi penale sipas Ligjit Nr.9754, datë 14.6.2007 Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridike, prandaj duhen deklaruar në formular vetëdeklarimi si ortak i OE Infosoft Systems.*

Tek formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, nuk është plotësuar në mënyrë korrekte seksioni B: Deklaratë për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen), pasi

janë vendosur vetëm emërtimi i kriterit të kërkuar në DST dhe nuk është vendosur emri i plotë i punonjësit që deklarohet se përmbush kriterin. Referuar nenit 82 të LPP dhe nenit 26 të RrPP, formulari i vetëdeklarimit plotësohet duke saktësuar dokumentin e kërkuar dhe burimin/façen e internetit ku është marrë ky dokument.

2. Nuk plotëson kriterin kualifikues të pikës 2.3.5 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të shtojcës 7 të DST-ve, pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi për produktin e ofruar, si më poshtë

Për produktin “Fotokopje A4 me ngjyra” ka ofruar modelin “MC3224i” të kompanisë prodhuese Lexmark, ndërkohë që ka paraqitur “Autorizim” nga Distributori i Autorizuar “ITD” SHPK për shoqërinë “INFOSOFT SYSTEMS” si dhe autorizim prodhuesi nga LEXMAR Zvicër, për INFOLEX S.A Greqi, dt. 02.01.2023 ku autorizohet firma italiane për të lëshuar letra për tender në Shqipëri, ndërkohë që autorizimi për “ITD” SHPK është lëshuar nga firma Italiane. Dokument i titulluar nga noteri “LEXMARK, dispozita të ndryshme”, pa datë, midis INFOLEX S.A dhe LEXMARK”, duke mos u bërë lidhja midis “ITD” SHPK dhe LEXMAR Zvicër.

3. Nuk plotëson pikën 2.3.6. Për Integrimin e platformës së menaxhimit në distancë të kompjuterëve dhe palmarëve me platformën e menaxhimit në Cloud, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton integrimin e tyre. Nuk ka paraqitur vërtetim nga prodhuesi për integrimin e platformës Manage Engine Endpoint Central Cloud + Service Desk Plus + Mobile Device Manager Plus.

4. Nuk plotëson pikën 2.1.1 Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të zërave që e kanë të domosdoshëm montimin dhe konfigurimin, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë: • Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Software për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale. • Të paktën 1 (një) punonjes te certifikuar në nivel profesional ITIL (Foundation Certificate in IT Service Managment) ose ekuivalente • Të paktën 2 (dy) punonjës të profileve inxhinier elektronik/telekomunikacioni /specialist TIK Për të vërtetuar kriterin e mësipërm, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomat/certifikatat përkatëse të punonjësit si dhe kontratë të vlefshme pune të lidhura midis operatorit ekonomik dhe punonjësit. Nga dokumentet e paraqitura apo formulari i vetëdeklarimit nuk janë paraqitur të dhënat për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Software për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale të ofruar nga OE i cili ka ofruar platformën Manage Engine, ndërkohë punonjësi i deklaruar për të përmbushur këtë kriter është i certifikuar nga një prodhues i një platforme tjetër menaxhimi, konkretisht Certified Proget Engineer.

5. Nuk plotëson pikën 2.3.3. për pajisjet Barkode reader . Referuar katalogut të paraqitur Pajisja e ofertuar BARCODE YES Blaster 2R nuk plotëson specifikimin:

Program i përfshirë Po, program që të gjenerojë të dhëna të skanimeve si dhe raporte, mundësi për të programuar skanerin si dhe upgrade të firmware.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se:

“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të

këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”, rezulton që oferta e më sipërme nuk kualifikohet.”.

II.5.1. Në datën 26.10.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3540 dhe me nr. 2630 prot., datë 26.10.2023, e operatorit ekonomik “Infosoft Systems” SHPK, lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Infosoft Systems” SHPK, kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Elektronik” SHPK, si dhe rivleresimin e ofertave të tjera në lidhje me kriterin e mënyrën e paraqitjes së sigurimit të ofertës nga operatorët ekonomikë BOE “Atom” SHPK & “Erisony Company” SHPK, “SINTEZA-CO” SHPK dhe “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit. duke argumentuar:

“[...] Ne lidhje me pretendimin e pare:

Nuk i ploteson kriteret per kualifikim dhe konkretisht nuk plotesohet: a. Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces 8 I. Formulari Permbledhes i Vetedeklarimit, duhet te plotesohet ne cdo seksion te tij duke cituar edhe faqen e internetit apo burimin e dokumentit qe verteton qe OE nuk eshte ne kriteret per skualifikim. OE Infosoft Systems nuk e ka plotesuar Formularin e Vetedeklarimit ne menyren e kerkuar nga ligji, pasi nuk ka deklaruar ne formular vetedeklarimi, konkretisht ne Pjesa II: Shkaqet e perjashtimit A: Deklarata per Permbushjen e Krieteve te Pergjithshme te Kualifikimit ortakun Tag Engineering shpk, i cili sipas ekstraktit te QKB rezulton ortak me pjesemarrje ne 30% nese eshte denuar me vendim te formes se prere nga gjykata. Rikujtojme qe personat juridike kane pergjegjesi penale sipas Ligjit Nr.9754, date 14.6.2007 Per Pergjegjesine Penale te Personave Juridike, prandaj duhen deklaruar ne formular vetedeklarimi si ortak i OE Infosoft Systems. Tek formulari permbledhes i vetedeklarimit, nuk eshte plotesuar ne menyre korrekte seksioni B: Deklarate per disponimin e punonjesve dhe makinerive te nevojshme (nese kerkohen), pasi jane vendosur vetem emertimi i kriterit te kerkyuar ne DST dhe nuk eshte vendour emri i plote i punonjesit qe deklarohet se permbush kriterin. Referuar nenit 82 te LPP dhe nenit 26 te RrPP, formulari i vetedeklarimit plotesohet duke sakteluar dokumentin e kerkuar dhe burimin/faqen e internetit ku eshte marre ky dokument.

Ju sqarojme se: referuar Nenit 92 te LPP (3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji) dhe Nenit 82 te VKM (Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme), Autoriteti duhet te bej vleresimin e ofertave mbi bazen e dokumentacionit te kerkuar dhe konkretisht ne Shtojcen 8 te DST eshte paraqitur Formulari Permbledhes i Vetdklarimit. Tek ky formular ne asnje seksion te tij nuk ka kerkese per detyrimin e paraqitjes se burimit te informacionit, sic pretendon Autoriteti, perkundrazi ne pjesen II te

ketij formulari ne cdo seksion ne fund te cdo deklarimi shprehet Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme. Duke qene se legjislacioni dhe institucionet zyrtare perkatese nepermjet sistemeve te verifikimit i japin te drejte cdo Autoriteti te verifikojë vertetesine e informacioneve te deklaruar si dhe te drejten e Autoritetit per te kerkuar sqarime, ne kemi permbushur detyrimin e deklarimit ne formular, por ne ndihme te Autoritetit dhe per ta siguruar ate mbi deklarimet tona ne kemi futur ne tender edhe dokumentacion zyrtar mbeshtetes, pa patur detyrimin e paraqitjes ne kete faze (Ekstrakt QKB, Vertetim mbi shlyerjen e detyrimeve tatimore, vertetim mbi shlyerjen e detyrimeve te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore, vertetim mbi statusin aktiv te kompanise dhe vertetim per shlyerje detyrimesh te OSHEE-se).

Per sa me siper pretendimi i Autoritetit eshte i pabazuar ne ligj apo dokumentacion sepse ne formularin e publikuar si pjese e dokumenteve standarde te tenderit, nuk ekziston pretendimi i Autoritetit si kerkese.

Gjithashtu referuar pretendimit te Autoritetit se (OE Infosoft Systems nuk e ka plotesuar Formularin e Vetedeklarimit ne menyren e kerkuar nga ligji, pasi nuk ka deklaruar ne formular vetedeklarimi, konkretisht ne Pjesa II: Shkaqet e perjashtimit A: Deklarata per Permbushjen e Kriterëve te Pergjithshme te Kualifikimit ortakun Tag Engineering ShPK, i cili sipas ekstraktit te QKB rezulton ortak me pjesemarrje ne 30% nese eshte denuar me vendim te formes se prerë nga gjykata. Rikujtojme qe personat juridike kane pergjegjesi penale sipas Ligjit Nr.9754, date 14.6.2007 Per Pergjegjesine Penale te Personave Juridike, prandaj duhen deklaruar ne formular vetedeklarimi si ortak i OE Infosoft Systems), ju sjellim ne vemendje se ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, ne pjesen e dyte, pika a, paragrafi 3, te ciles ju pretendoni se ne nuk e kemi plotesuar ne menyre korrekte kerkohet specifikisht te listohen PERSONI ose PERSONAT, dmth individ (si me poshte)

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të forms së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme

Dhe ne permbushje te kerkeses ne kemi deklaruar:

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

Z.Armand Shara,

Znj.Edlira Shara,

Z.Bledar Dhima,

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

Per sa me sipër pretendimi i Autoritetit është i pabazuar në ligj apo dokumentacion sepse në formularin e publikuar si pjesë e dokumenteve standarde të tenderit, nuk ekziston pretendimi i Autoritetit si kërkesë

Gjithashtu referuar pretendimit se “Tek formulari përmbledhës i vetedeklarimit, nuk është plotësuar në mënyrë korrekte seksioni B: Deklarate për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nese kerkohen), pasi janë vendosur vetëm emertimi i kriterit të kerkuar në DST dhe nuk është vendur emri i plote i punonjësit që deklarohet se përmbush kriterin, ju sqarojme se referuar kërkesës së autoritetit dhe formularit në kemi plotësuar në mënyrë korrekte informacionin e kerkuar duke deklaruar profilin e punonjësve ekzaktesisht sipas kërkesave të Autoritetit dhe kemi vendosur edhe inicialin e emrit dhe mbiemrin e plote të punonjësit/punonjësve që e plotësojnë këto kriter. Në mbështetje të saj kemi paraqitur në tender edhe Certifikatat e stafit (me emer mbiemer të plote), Diplomat e stafit (me emer mbiemer të plote), si dhe listepagesat e shoqërisë (me emer mbiemer të plote), në mënyrë që Autoriteti të kishte mjaftueshëm informacion mbi kapacitetet tona profesionale.

Per sa me sipër pretendimi i Autoritetit është i pabazuar në lidhje dhe dokumentacion sepse në tender janë paraqitur të gjitha të dhënat, madje edhe me dokumentacion shtesë mbështetës që në fazën e ofertimit (pa qene detyrimin, por me qëllimin e mirë që të garantohet autoriteti për kapacitetet teknike-profesionale).

Ju sjellim në vëmendje se mbështetur mbi Neni 92 të LPP, (Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave), Neni 87 të LPP ”4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit”, Neni 82 të VKM (Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal) si dhe Neni 82 të LPP dhe 26 të VKM (Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose ti kerkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime), Autoriteti nese nuk do të mund të verifikonte deklaratimet nepermjet mjeteve, websiteve dhe metodave elektronike të vendosura në dispozicion nga ana e shtetit, duhet të kerkojë sqarime nga ana e Ofertuesve. Në konkluzion të arsyetimeve të mesiperme, pretendimet e Autoritetit nuk janë në përputhje me legjislacionin e prokurimit publik, me konkretisht Neni 92 të LPP "Shqyrtimi i ofertave", Neni 82 i VKM "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" dhe si të tilla ato nuk qëndrojnë.

Ne lidhje me pretendimin e dytë:

2. Nuk plotëson kriterin kualifikues të pikës 2.3.5 Kriteret e veçanta të Kualifikimit të shtojcës 7 të OST-ve, pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi për produktin e ofruar, si më poshtë: Per produktin 'Fotokopje A4 me ngjyra ka ofruar modelin MC3224 të kompanisë prodhuese Lexmark, nderkohe që ka paraqitur Autorizim nga Distributori i Autorizuar ITD SHPK për shoqërinë INFOSOFT SYSTEMS si dhe autorizim prodhuesi nga LEXMAR Zvicër, për INFOLEX S.A Greqi, dt 02.01.2023 ku autorizohet firma italiane për të leshuar letra për tender

ne Shqiperi, nderkohe qe autorizimi per ITD SHPK eshte leshuar nga firma Italiane. Dokument i titulluar nga noteri LEXMARK, dispozita te ndryshme, pa date, midis INFOLEX S.A dhe LEXMARK, duke mos u bere lidhja midis ITD SHPK dhe LEXMAR Zvicer.

Se pari ju sqarojme se ne dokumentet e paraqitur ne oferten tone per te plotesuar kriterin 2.3.5 te DST, nuk ekziston asnje kompani italiane qe te jete e autorizuar nga Lexmar apo Infolex, apo qe kjo kompani italiane te autorizojte ITD ShPK.

Ne oferten tone jane paraqitur:

1. Autorizim nga ITD ShPK si distributor i autorizuar i produkteve Lexmark,
2. Marreveshje distribucioni Infolex S.A-ITD ShPK (material i shkeputur per shkak te konfidencialitetit te elementeve te kontrates),
3. Deklarate e Lexmark International Technology Sarl, ku shprehet qarte se Infolex eshte perfaqesues i tyre dhe i ka dhene te drejta te plota per te leshuar dokumentacion per tender sepse Lexmark nuk leshon me ne menyre direkte dhe asnje distributor nuk ka me marredhenie me Lexmark, por me Infolex.

Ju sjellim ne vemendje se ne te gjitha dokumentet e dorezuara ne tender INFOLEX S.A eshte kompani me adrese ne Greqi dhe eshte e vetmja qe rezulton te te gjitha dokumentet e paraqitura.

Ne perputhje me kerkesat e tenderit ne kemi zgjedhur te ofertojme produkte Lexmark duke qene se permbushin specifikimet ne menyre te plote si dhe per shkak te partneritetit ne ofrojme cmime me te favorshme per Autoritetin.

Me ane te dokumentacionit te ofruar ne ju kemi paraqitur marredhenien qe ekziston midis Lexmark - Infolex dhe ITD.

Nepermjet shkreses se Leshuar nga Lexmark International Technology Sarl vertetohet se Lexmark nuk ka marredhenie drejte per drejte me distributoret, por autorizon Infolex S.A te perfaqesoje ate ne lidhje me distributoret ne rajonet e percaktuara ne deklarate (Greqi, Qipro, Malta, Shqiperi Maqedoni e Veriut dhe Kosove). Politikat e Lexmark qe nga muaji Tetor i vitit 2013, nuk lejojne me lidhje direkte te distributoreve te cdo vendi me ta, por eshte autorizuar Infolex qe te veproje ne emer te tyre.

Nen kete marredhenie Infolex nenshkruan kontrata distribucioni ne vendet per te cilat ai eshte i autorizuar nga Lexmar. Ne kete kuader ITD ShPK nepermjet marreveshjes midis tyre dhe Infolex, eshte distributor i autorizuar nga Infolex dhe rrjedhimisht Lexmark, sepse i jane deleguar kompetencat. Per kete arsye ju eshte vene ne dispozicion nje pjesë e kontrates se firmosur ndermjet INFOLEX S.A dhe ITD SHPK, qe te paraqitej lidhja midis tyre.

Duke qene se ITD shpk eshte distributor zyrtar i Lexmark per territorin e Shqiperise dhe Kosoves dhe per rrjedhoje mund te leshoje Autorizim Distributori per procedura te ndryshme tenderimi, sic eshte dhe rasti konkret, ne kemi paraqitur Autorizimin e leshuar per shoqerine INFOSOFT SYSTEMS shpk me date 29.08.2023, drejtuar Autoritetit.

Ne permbushje te kriterit te kualifikimit ne kemi paraqitur dokumentacionin e nevojshem per te vertetuar: Lidhjen midis Lexmark dhe Infolex, ku ky i fundit eshte perfaqesues e autorizuar per Shqiperine dhe shtetet Greqi, Qipro, Malta, Maqedoni e Veriut dhe Kosove. Ne dokument paraqitet qarte qe prodhuesi Lexmark nuk leshon asnje dokumentacioni te natyres se kerkuar ne kete tender (MAF ose DAF). Nga ana tjeter kemi paraqitur ekstraktin e kontrates midis Infolex SA dhe ITD ShPK qe verteton lidhjen midis Infolex (si perfaqesues i autorizuar nga Lexmark) dhe ITD SHPK ne statusin e distributorit te autorizuar per Shqiperine dhe Kosoven.

ITD Shpk ka leshuar dokumentin DAF te paraqitur ne tender. Rrjedhimisht, me keto tre dokumenta te paraqitur, vertetohet me se miri lidhja midis Lexmark dhe ITD shpk, ku ky i fundit eshte distributor i autorizuar per produktet e prodhuesit Lexmark, dhe si i tille ka leshuar Autorizim nga Distributori DAF per Infosoft Systems.

Ne te gjithë eksperiencen tone te deri tanishme me cdo Autoritet Kontraktor nuk kemi patur asnje lloj pretendimi ne lidhje me kete pike, madje kompania jone nga vet Institucioni juaj eshte shpallur fitues me te njejtin dokumentacion te paraqitur, ku eshte vertetuar lidhje e Lexmar me Infolex dhe ka realizuar kontrata te suksesshme. Ky pretendim tani eshte i paarsyesshem dhe i pabazuar ne ligj apo dokumentacion tenderi. Ne menyre qe t'ju sigurojme se pohimet tona te mesiperme ne lidhje me dokumentacionin e dorezuar ne tender, i cili eshte ne permbushje te plote te kriterëve te DST, ju lutem gjeni bashkengjitur nje deklarate te leshuar nga ana e Infolex S.A e cila ju ri konfirmon se kompania ITD ShPK eshte Distributor i Autorizuar per terrtorin e Shqiperise dhe Kosoves.

Referuar Nenit 82 te VKM "2.Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i."Devijimi" është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. "Rezervimi" është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii."Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë", dhe Nenit 92 te LPP "1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohej, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit", oferta jone eshte ne perputhje te plote me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit sepse ne kete e kemi vertetuar me ane te dokumentacionit te dorezuar.

Ne lidhje me pretendimin e trete:

3. Nuk ploteson piken 2.3.6. Per Integrimin e platformes se menaxhimit ne distance te kompjuterave dhe palmereve me platformen e menaxhimit ne Cloud, ofertuesi duhet te paraqese dokumentacionin qe verteton integrimin e tyre. Nuk ka paraqitur vertetim nga prodhuesi per integrimin e platformes Manage Engine Endpoint Central Cloud + Service Desk Plus + Mobile Device Manager Plus.

Ju sqarojme se Infosoft Systems ka paraqitur ne oferten produkt **software**, konkretisht Manage Engine. Kjo platforme, sic mund te vertetohet edhe ne datasheet te paraqitur ne tender, ku dhe eshte marre ekstrakti ne vijim, (ilustrimi gjendet ne formularin e ankeses ne attached, per pamundes bashkengjitje figurash.) eshte ne gjendje te menaxhoje jo vetem pajisje Desktop por edhe shume tipe pajisjesh te tjera, nder to dhe pajisje te levizshme mobile me sisteme operative te tipit Android, ChromeOS, IOS etj. Pajisjet palmare te ofertuara nga Infosoft Systems jane pajisje mobile me sistem operativ Android dhe si te tilla menaxhohen plotesisht nga platforma Manage Engine. Detajime te metejshme teknike te cilat ndodhen ne datasheet 1.1 Endpoint Central, shpjegojne me hollesi kapacitetet teknike te produktit Manage Engine, i cili permbush dhe tejkalon kerkesat e paraqitura ne kete prokurim. Ne ekstraktin ne vijim paraqitet informacioni mbi sistemin operativ te pajisjeve palmare, shkeputur nga datasheet i dorezuar per kete pajisje. (ilustrimi gjendet ne formularin e ankeses ne attached, per pamundes bashkengjitje figurash.) Ne lidhje me pretendimin "Në rast se janë produkte nga prodhues të ndryshëm, ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim nga secili prodhues për integrimin e tyre. Mos paraqitja e vërtetimeve nga prodhuesit është kusht për skualifikim", ju sqarojme se nuk jemi ne rastin e siperpermendur sepse sic mund te verifikohet lehtesisht Infosoft Systems ka ofertuar softëare te nje prodhuesi te vetem, qe eshte Manage Engine. Rrjedhimisht nuk qendron argumentimi i Autoriteti Kontraktor, pasi nuk jane ofertuar platforma software nga prodhues te ndryshem, por vetem nje platforme e vetme e unifikuar qe do te menaxhoje si pajisjet Desktop ashtu edhe ato palmare.

Referuar Nenit 82 te VKM "2.Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i."Devijimi" është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit, ii. "Rezervimi është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii."Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Ne çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë", dhe Nenit 92 te LPP "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, oferta jone eshte ne perputhje te plote me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe modifikimet sepse ne kete e kemi vertetuar me ane te dokumentacionit te dorezuar.

Ne lidhje me pretendimin e katert:

4. Nuk ploteson piken 2.1.1 Per te garantuar cilesine e punes gjate instalimit/konfigurimit te zerave qe e kane te domosdoshem montimin dhe konfigurimin, operatori ekonomik ofertues duhet te disponoje staf te kualifikuar me kerkesat minimale si me poshte: ? Te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivelin profesional nga prodhuesi per Software per monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale. Te pakten 1 (nje) punonjes te certifikuar ne nivel profesional ITIL (Foundation Certificate in IT Service Management) ose ekuivalente ? Te pakten 2 (dy) punonjes te profileve inxhinier elektronik/telekomunikacioni /specialist TIK Per te vertetuar kriterin e mesiperm, operatori ekonomik duhet te paraqese diplomat/certifikatat perkatese te punonjesit si dhe kontrate te vlefshme pune te lidhura midis operatorit ekonomik dhe punonjesit.

Nga dokumentet e paraqitura apo formulari i vetedeklarimit nuk jane paraqitur te dhenat per te pakten 1 (nje) specialist te certifikuar ne nivelin profesional nga prodhuesi per Software per monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale te ofruar nga OE i cili ka ofruar platformen Menage Engine, nderkohe punonjesi i deklaruar per te permbushur kete kriter eshte i certifikuar nga nje prodhues i nje platforme tjeter Menaxhimi, konkretisht Certified Proget Engineer.

Ne lidhje me kete pretendim, e vleresojme te domosdoshme t'ju sjellim ne vemendje se Autoriteti ka publikuar ne sistemin e APP-se nje dokument me emertimin " NJOFTIM MODIFIKIMESH APP Kompjutera", ku ne permbajtje te saj eshte edhe modifikimi i kriterit 2.1.1 te Kapaciteteve profesionale te operatorit ekonomik: Në shtojca 7, Formulari i Kriereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit: të Dokumenteve standarde të tenderit, bëhet modifikimi si vijon: Pika 2.1.1. ISHTE:

Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të zërave që e kanë të domosdoshëm montimin dhe konfigurimin, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Software për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale.

Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional ITIL (Foundation Certificate in IT Service Management) ose ekuivalente

Të paktën 2 (dy) punonjës të profileve inxhinier elektronik/telekomunikacioni /specialist TIK

Pika 2.1.1. BËHET:

Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të zërave që e kanë të domosdoshëm montimin dhe konfigurimin, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

? Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Software për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale ose ekuivalente.

? Të paktën 1 (një) punonjes te certifikuar në nivel profesional ITIL (Foundation Certificate in IT Service Managment) ose ekuivalente

Të paktën 2 (dy) punonjës të profileve inxhinier elektronik/telekomunikacioni /specialist ?TIK

Persa me siper Autoriteti ka bere vleresimin ne lidhje me kriteret e vjetra te kualifikimit dhe jo ato te modifikuara te cilat prevalojne, per kete arsye pretendimi bie poshte sepse nuk eshte i drejte dhe legjitim. Ky pretendim bie ne kundërshtim me kerkesat e ligjit (Nenit 92 te LPP "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji). Megjithate per te siguruar Autoritetin se ne gezojme kapacitetet e duhura, ju sqarojme se ne lidhje me plotesimin e kesaj kerkese dhe ne perputhje me modifikimin e bere nga vete Autoriteti Kontraktor "Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Software për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale ose ekuivalente", Infosoft Systems ka paraqitur Certifikaten "Certified Proget Engineer" te punonjesit Andi Shkumbini, per produktin MDM te prodhuesit Proget.

Ne faqen zyrtare te ketij prodhuesi mund te gjendet informacion i hollesishem mbi platformen e menaxhimit te pajisjeve te prodhuesit Proget, ku dhe verifikohen aftesite teknike dhe funksionale te ketij produkti si dhe ngjashmeria teknike me produktin e ofertuar Manage Engine. Reference:

Zarządzanie urządzeniami mobilnymi – Proget

Ne lidhje me pretendimin e peste:

5. Nuk ploteson piken 2.3.3. per pajisjet Barkode. reader. Referuar katalogut te paraqitur Pajisja e ofertuar BARCODE YES Blaster 2R nuk ploteson specifikimin: Program i perfshire Po, program qe te gjeneroje te dhena te skanimeve si dhe raporte, mundesi per te programuar skanerin si dhe upgrade te firmware. Ju sqarojme se pajisjet Barkode Reader Blaster 2R te ofertuar ploteson specifikimin "Program i perfshire Po, program qe te gjeneroje te dhena te skanimeve si dhe raporte, mundesi per te programuar skanerin si dhe upgrade te firmware." dhe kete gje e kemi deklaruar edhe ne oferten teknike, printscreen si me poshte:

Ne permbushje te kerkesave te Autoritetit, Infosoft Systems ka plotesuar kerkesen per program te perfshire. Kete gje mund ta verifikoni te linku i faqes se prodhuesit i paraqitur ne vijim. <https://www.eia.it/downloadpg.php> (print screen gjendet ne formularin e ankeses bashkengjitur, per pamundesi bashkengjitje figurash). Pra ne faqen zyrtare te prodhuesit gjendet linku per te shkarkuar software perkates per menaxhimin e produktit barcode reader te ofertuar. Nepermjet ketij software mund te realizohet: Mundesi per te programuar skanerin, mundesi per upgrade firmware, gjenerim te te dhenave te skanimit etj. Ne vijim gjeni dhe printscreen qe verteton funksionalitetet e kerkuara. (print screen gjendet ne formularin e ankeses bashkengjitur, per pamundesi bashkengjitje figurash).

Per sa me siper pretendimi i Autoritetit nuk qendron.

Referuar Nenit 82 te VKM "2.Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtë: i."Devijimi" është shmangia e ofertuesit nga kërkesat e specifikuara në dokumentet e tenderit; ii. "Rezervimi është përcaktimi, nga ana e ofertuesit, i kushteve kufizuese ose ndalimi nga pranimi i plotë i kërkesave të specifikuara në dokumentet e tenderit; dhe iii."Mospranimi" është mosparaqitja e një pjese ose

e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit. Nëse është e nevojshme, komisioni i vlerësimit të ofertave kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal. Në çdo rast, kur autoriteti/enti kontraktor vendos të marrë në konsideratë sqarimet e operatorit ekonomik, nuk duhet të bjerë në kundërshtim me përcaktimet në këtë pikë", dhe Nenit 92 të LPP "3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji, oferta jone është në përputhje të plote me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit sepse ne kete e kemi vertetur me ane te dokumentacionit te dorezuar.

Do të deshironim të sillnim në vemendjen Tuaj, si Autoritetit Kontraktor Posta Shqiptare sha ashtu edhe Komisionit të Prokurimit Publik, kriterin e paraqitjes së sigurimit të ofertës për tenderin në fjale. Në dokumentet standarde të këtij tenderi, në ndryshim nga pothuajse të gjithë autoritetet e tjera (bazuar në eksperiencën tonë të thellë në fushën e prokurimeve), Autoriteti si mënyrë për paraqitjen e Sigurimit të Ofertës pranon vetëm të depozitimit të pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor. Duke përjashtuar, në vlerësimin e tij, dy mënyrat e tjera (garancinë bankare apo sigurim nga shoqëri sigurimi e licencuar).

Pjesë e DST:

3.1.2 Autoriteti/enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor shënohet numri i llogarisë bankare të autoritetit ose entit kontraktor)

Banka: Raiffeisen bank

Adresa Bankes: Rruga Kavajes, Tirane/Shqiperi

Sëift Code: SGSBALXXXX

IBAN: AL52202110130000000100004546

Emri i llogarisë: Posta Shqiptare sh.a

Adresa: Rruga Reshit Çollaku, Tirana/ Shqiperi

Monedha: ALL

3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën: i. garancisë bankare ? ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente?

Në përputhje të plote me këtë kërkesë në kemi bërë depozitimin e shumës së sigurimit dhe një i kemi vertetur pagesën Autoritetit me anë të mandatit bankar si dhe një deklaratë të dorëzuar në tender.

Duke qenë se kjo metodë nuk është përdorur në tendera të mëparshëm, duke njohur kapacitetet, eksperiencën e operatoreve që veprojnë në treg, kemi bindjen se operatorët e tjerë ekonomikë që kanë marrë pjesë në këtë tender, nuk e kanë respektuar këtë kriter të Autoritetit Kontraktor dhe duhet të kenë paraqitur sigurim oferte të leshuar nga shoqëri sigurimi si mënyrë pa kosto të larta për ta, por që normalisht është arsye skualifikimi.

Në përputhje me detyrimet ligjore të vlerësimit të ofertave dhe parimet e Ligjit të Prokurimit Publik "Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale", ju lutemi të verifikoni nëse operatori ekonomik (i vetmi i kualifikuar) BNT Electronis ka paraqitur

sigurimi i ofertes ne perputhje me kerkesat e Autoritetit dhe legjislacionit perkates (Neni 83 LPP-2. Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor pranon mundësinë e pagesës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor. Përveç kësaj forme të paraqitjes së sigurimit të ofertës, autoriteti ose enti kontraktor, sipas vlerësimit të tij, duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit mundësinë e paraqitjes së sigurimit të ofertës: i. në formën e garancisë bankare; ose ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente).

Duke respektuar vleresimin e Autoritetit do t'ju luteshim te benit rivleresimin e ofertave te paraqitura duke marre ne shqyrtim edhe kriterin e mesiperem te kualifikimit, si nje kriter garantues dhe mbrojtës i vendosur nga legjislacioni duke i dhene nje mjet konfiskimi dhe demshperblimi per rastet e parashikuara ne Nenin 83.6 LPP. Gjithashtu ju lutemi ta merrni ne konsiderate edhe ne kuader te trajtimit te barabarte te operatoreve ekonomike, sepse per ata qe mund ta kene respektuar formen e paraqitjes se sigurimit te ofertes, ajo ka sjelle kosto te larta dhe ngurtesim ne llogarine e Institucionit te nje shume te konsiderueshme per nje kohe relativisht te gjate. Per me teper qe nisur nga ky kriter, mund te kete operatore te tjere te cilet veprojne ne treg, por nuk jane paraqitur ne tender pasi e kane pasur te pamundur ngurtesimin e nje vlere monetare. Vendosjen e ketij kriteri, Posta Shqiptare si Autoritet Kontaktor, duhet ta kete te rendesishme ne vleresimin e ofertes pjesmarrese ne tender, ne te kundert, cfare vlere do te kishte ky kriter perzgjedhes. Ne perfundim te arsytetimeve tona kerkojme rivleresimin e ofertes tone si oferte e pergjegjshme dhe e kualifikuar, si dhe rivleresimin e ofertave te tjera ne lidhje me kriterin e menyren e paraqitjes se sigurimit te ofertes.”

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2630/2 prot, datë 27.10.2023, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimes “Infosoft Systems” SHPK, kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Elektronik” SHPK si dhe rivleresimin e ofertave të tjera në lidhje me kriterin e mënyrën e paraqitjes së sigurimit të ofertës nga operatorët ekonomikë BOE “Atom” SHPK & “Erisony Company” SHPK, “Sinteza-Co” SHPK dhe “I.S.S (INTEGRATED SMART SOLUTIONS)” SHPK në procedurën e mësipërme e prokurimit.

II.5.2. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike më datë 01.11.2023, protokolluar me tonën me nr.2630/3 prot., datë 01.11.2023, operatori ekonomik “BNT Electronics” SHPK ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumenteve, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020, “Për Prokurimin Publik”.

II.5.3.Me shkresën me nr. 2630/4 prot., datë 09.11.2023 me objekt: “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik Infosoft Systems SHPK”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion si

vijon: “[...] Aktualisht, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dërguar asnjë informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke mos përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në nenin e sipërcituar, për vënien në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, të shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 114 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Infosoft Systems” SHPK si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues”.

II.5.3. Me anë të shkresës Nr.1497/16 prot., datë 13.11.2023, protokolluar pranë institucionit tonë me Nr.2630/5 prot., datë 14.11.2023, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit si dhe informacion mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Infosoft Systems” SHPK, nga ku rezulton, se autoriteti kontraktor nuk e ka pranuar atë.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Systems” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: *“Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE në sistemin elektronik të APP-se, u konstatua se: Nuk i plotëson kriteret për kualifikim dhe konkretisht nuk plotësohet: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

1. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, duhet të plotësohet në çdo seksion të tij duke cituar edhe faqen e internetit apo burimin e dokumentit që vërteton që OE nuk është në kriteret për skualifikim. OE “Infosoft Systems” nuk e ka plotësuar Formularin e Vetëdeklarimit në mënyrën e kërkuar nga ligji, pasi nuk ka deklaruar në formular vetëdeklarimi, konkretisht në Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit A: Deklarata për Përmbushjen e Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit ortakun Tag Engineering ShPK, i cili sipas ekstraktit të QKB rezulton ortak me pjesëmarrje në 30%, nëse është dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata. Rikujtojmë që personat juridike kanë përgjegjësi penale sipas Ligjit Nr.9754, datë 14.6.2007 Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridike, prandaj duhen deklaruar në formular vetëdeklarimi si ortak i OE Infosoft Systems.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 7

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkm, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

III.1.2. Në shtojcën 8 të dokumenteve standarde të tenderit, kriteret e veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	----- -
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- ----
Përfaqësuesi (emri):	-----

Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- -----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <hr/> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p>

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në mbështetje të Ligjit Nr. 9121/2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bëj këtë deklaram dhe garantoj se, deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;
2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s’kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;
3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;
4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;
5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala “konkurrentë” nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.
6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):
 - a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
 - b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
 - a) çmimet ;
 - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
 - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,

d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:
Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe

aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligjin Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: _____ Profili i punonjësve

noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	<hr/> <hr/> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] <u>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</u> <hr/>
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetëdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*
- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK, si dhe informacionit të dhënë nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton, se operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK ka paraqitur në SPE dokumentacionin me emërtimin:

- Formularin i vetëdeklarimit, ku në Pjesa II, pika B, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” është plotësuar si vijon:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

NUIS: J61820021C

InfoSoft Systems sh.p.k
Rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2251 180/1; Fax: +355 4 2232 990
E-mail: infosoft@infosoftgroup.com.al
Web: www.infosoftsystems.al

InfoSoft Systems

Pjesë e InfoSoft Group

Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:

Z.Armand Shara,

Znj.Edlira Shara,

Z.Bledar Dhima,

nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.

<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.
<i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

NUIS: J61820021C

InfoSoft Systems sh.p.k
Rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tiranë, Shqipëri
Tel: +355 4 2251 180/1; Fax: +355 4 2232 990
E-mail: infosoft@infosoftgroup.com.al
Web: www.infosoftsystems.al

III.1.3. Në nenin 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

1. Çdo operator ekonomik që është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përmendura në këtë pikë, skualifikohet nga procedurat e prokurimit publik për një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata. Ky skualifikim bëhet për veprat penale të mëposhtme:

- a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- b) korrupsion sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- c) mashtrim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- ç) pastrim parash ose financim të terrorizmit sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi;
- dh) falsifikim;

e) puna e fëmijëve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Detyrimi për skualifikimin e një operatori ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operatori ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:

a) operatori ekonomik është në proces gjyqësor dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë, sipas legjislacionit në fuqi;

b) operatori ekonomik i ka përmbushur detyrimet e tij, duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore që duhet të paguajë, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit;

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shumën të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh;

ç) operatori ekonomik është informuar për shumën e saktë që duhet të paguajë pas shkeljes së detyrimit të tij për të paguar taksat ose kontributet e sigurimeve shoqërore, në një kohë të tillë kur nuk ka pasur mundësi të marrë masat e nevojshme për shlyerjen e tyre, përpara skadimit të afatit për dorëzimin e kërkesës për pjesëmarrje/ofertës.

3. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

b) operatori ekonomik ka falimentuar ose është subjekt i procedurave të falimentimit, kur asetet e tij administrohen nga një administrator falimentimi ose nga gjykata, kur ekziston një marrëveshje me kreditorët, kur veprimtaritë e tij të biznesit janë pezulluar ose ai ndodhet në një situatë të ngjashme që ka lindur nga një procedurë e ngjashme në zbatim të legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rastit të parashikuar në nenin 47, pika 2, shkronja “ç”, të këtij ligji;

c) operatori ekonomik është shpallur fajtor me vendim gjyqësor të formës së prerë për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

ç) autoriteti ose enti kontraktor provon se operatori ekonomik ka lidhur marrëveshje me operatorë ekonomikë të tjerë që kanë si qëllim të shtrembërojnë konkurrencën;

d) operatori ekonomik ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

dh) operatori ekonomik është tërhequr nga nënshkrimi i kontratës në një procedurë prokurimi të zhvilluar nga vetë autoriteti ose enti kontraktor. Ky kusht zbatohet brenda një viti kalendarik nga tërheqja;

e) operatori ekonomik ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një

kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate, për të cilën është përjashtuar sipas parashikimeve në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 78 të këtij ligji.

ë) operatori ekonomik ka paraqitur deklarata të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;

f) autoriteti kontraktor ka informacion të provuar se operatori ekonomik ka marrë përsipër të ndikojë në mënyrë të gabuar procesin e vendimmarrjes së autoritetit ose entit kontraktor për të marrë informacion konfidencial, që mund t'i japë atij avantazh të padrejtë në procedurën e prokurimit, ose nga pakujdesia të japë informacione të gabuara që mund të kenë ndikim domethënës në vendimet që lidhen me përjashtimin, përzgjedhjen ose prokurimin.

g) operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

4. Në rrethana të jashtëzakonshme, që lidhen me arsye thelbësore të interesit publik, si shëndeti publik apo mbrojtja e mjedisit, të konfirmuara nga autoritetet kompetente, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të mos e skualifikojë operatorin ekonomik, pavarësisht parashikimeve të pikës 3 të këtij neni.

5. Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raporton në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji.

6. Operatori ekonomik që ndodhet në një nga kushtet e skualifikimit të parashikuara në këtë nen mund të paraqesë prova me qëllim për të vërtetuar se masat e marra prej tij janë të mjaftueshme për të treguar besueshmërinë e tij, pavarësisht ekzistencës së kushteve për skualifikim.

Për këtë qëllim, operatori ekonomik duhet të provojë që ka paguar apo ka marrë angazhim të paguajë kompensim për çdo dëm të shkaktuar si pasojë e kryerjes së një vepre penale apo shkeljeje ligjore, që ka sqaruar faktet dhe rrethanat në mënyrë gjithëpërfshirëse duke bashkëpunuar me autoritetet hetimore dhe që ka marrë masa konkrete organizative dhe për personelin të përshtatshme për parandalimin e veprave penale apo shkeljeve të tjera.

Masat e marra nga operatori ekonomik duhet të vlerësohen duke marrë parasysh rëndësinë dhe rrethanat e posaçme të veprës penale apo të shkeljes. Nëse masat e marra konsiderohen të pamjaftueshme, operatorit ekonomik i jepen arsyet për një vendim të tillë.

7. Operatori ekonomik, i përjashtuar me vendim përfundimtar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit apo koncesionit, nuk ka të drejtë të përdorë mundësinë e parashikuar nga pika 6 e këtij neni gjatë periudhës së përjashtimit të përcaktuar në këtë vendim.

III.1.4. Në nenin 77, pika 1, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.1.4. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.”

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor,

për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.7. Në rastin konkret, nisur nga arsyeja e skualifikimi të operatorit ekonomik, Komisioni gjykon se në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor/enti kontraktor të cilat shërbejnë si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Nga verifikimi i Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të dhënat e subjektit “Infosoft Systems” SHPK, të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit rezulton se ortak të shoqërisë “Infosoft Systems” SHPK janë: z.B.Dh, z.A. Sh dhe “Tag Engineering” SHPK. Referuar arsyes së skualifikimit, pretendimeve të ngritura në ankesë nga operatori ekonomik ankimues, si dhe nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet, se operatori ekonomik “Infosoft Systems” SHPK ka dorëzuar Shtojcën 8 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”. Nga shqyrtimi i saj, rezulton se në Pjesën II, pika B, “Deklarata për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit” nuk ka plotësuar paragrafin:

Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

<i>Sqarime</i>	<i>nëse</i>	<i>vlerësohet</i>	<i>e</i>	<i>nevojshme</i>
----------------	-------------	-------------------	----------	------------------

për ortakun “Tag Engineering” SHPK, në përputhje me gjendjen reale që pasqyron ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit. Operatori ekonomik ankimues në përputhje me paragrafin e sipërcituar duhet të deklaronte edhe operatorin ekonomik “Tag Engineering” SHPK. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Systems” SHPK nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit pikën 1/d të Shtojcës 7 të saj, për dhënien e informacionit të plotë dhe të saktë në Formularin e Vetëdeklarimit, pasi në dokumentacionin e ngarkuar në SPE nuk është deklaruar për ortakun “Tag Engineering” SHPK, nëse është apo jo i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP ose ka qenë dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5 vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK nuk është në përputhje me

kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga ana e tij nuk është plotësuar Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, ku në të deklarohet edhe për ortakun “Tag Engineering” SHPK sipas Ekstraktit të Regjistrimit Tregtar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Systems” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: *Nuk plotëson kriterin kualifikues të pikës 2.3.5 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të shtojcës 7 të DST-ve, pasi nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi për produktin e ofruar, si më poshtë: Për produktin “Fotokopje A4 me ngjyra” ka ofruar modelin “MC3224i” të kompanisë prodhuese Lexmark, ndërkohë që ka paraqitur “Autorizim” nga Distributori i Autorizuar “ITD” SHPK për shoqërinë “INFOSOFT SYSTEMS” si dhe autorizim prodhuesi nga LEXMAR Zvicër, për INFOLEX S.A Greqi, dt 02.01.2023 ku autorizohet firma italiane për të lëshuar letra për tender në Shqipëri, ndërkohë që autorizimi për “ITD” SHPK është lëshuar nga firma Italiane. Dokument i titulluar nga noteri “LEXMARK, dispozita të ndryshme”, pa datë, midis INFOLEX S.A dhe LEXMARK”, duke mos u bërë lidhja midis “ITD” SHPK dhe LEXMAR Zvicër, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.2.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.5.e tyre, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.5 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga prodhuesit ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesit, për tregtimin e artikujve objekt prokurimi (sipas tabelës së përcaktuar në pikën 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim) ku te jete ne përputhje me specifikimet teknike. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Ndërsa në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.3 *Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt objekt prokurimi, sipas tabelës së mëposhtme:*

A	B	C	D
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese	Specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve
1	<i>Kompjuter</i>		
2	<i>Printer Multifunksionale</i>		
3	<i>Printer Termik</i>		
4	<i>Printer Traktor</i>		
5	<i>Fotokopje A4 me ngjyra</i>		

6	Palmar		
8	Barcod Reader		

III.2.2. Nga verifikimi i dokumenteve të dorëzuara në SPE, në funksion të artikullit objekt - prokurimi, 5.Fotokopje A4 me ngjyra, të përcaktuar në pikën 2.3.3.të kriterëve të veçanta të kualifikimit, operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar Shtojcën 5, Formulari i specifikimeve teknike, të plotësuar dhe nënshkruar prej tij, ku për këtë artikull ka deklaruar *Lexmark MC3224i* me specifikimet përkatëse të tij. Në funksion të përmbushjes së kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.5. të dokumenteve të tenderit, për këtë artikull operatori ekonomik “Infosoft Systems” SHPK ka paraqitur:

- *Deklaratë datë 02.01.2023, lëshuar nga Lexmark, i përkthyer dhe noterizuar, me përmbajtje: “... Infolex S.A është trajnuar dhe autorizuar për furnizimin e produkteve të markës Lexmark dhe ofrimin e shërbimeve përkatëse. Duke vepruar kështu, Infolex S.A. do të veprojë në emër të saj dhe për llogari të saj. Lexmark konfirmon se Infolex S.A. ka autoritetin të lëshojë letrat e nevojshme për tenderat në të gjitha vendet e listuara më sipër. Për më tepër që nga tetori 2013, në përputhje me politikën e Lexmark, lexmark nuk lëshon më letra për rishitësit vendas në territorin e sipërpërmendur...”*

- *Një pjesë e aktmarrëveshjes, lidhur mes Infolex S.A. dhe ITD SHPK, e përkthyer dhe e noterizuar.*

- *Autorizim , nr.40 prot., datë 29.08.2023, i kompanisë ITD SHPK, sipas të cilit kompania ITD ShPK, si distributore e autorizuar në territorin e Shqipërisë për shitjet e produkteve të markës Lexmark..., autorizon kompaninë Infosoft Systems të paaqesë ofertë në tenderin me objekt: Blerje pajisje informatike....*

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” , të ndryshuar, parashikon se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor,

social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.5. Në nenin 77, pika 1, të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.2.6. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.7. Në nenin 40, pika 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike,*

autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik". Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.10. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit, ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributori të autorizuar ku të vërtetohet lidhja me prodhuesin, për të gjithë mallrat objekt - prokurimi. Për artikullin objekt prokurimi, 5. Fotokopje A4 me ngjyra, të përcaktuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit, operatori ekonomik

ankimues ka deklaruar *Lexmark MC3224i*. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik ankimues “InfoSoft Systems” SHPK, KPP konstaton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përmendur në pikën III.2.2. të këtij vendimi. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se me deklaratën e datës 02.01.2023, lëshuar nga Lexmark, për Infolex S.A., provohet që ky i fundit vepron në emër dhe për llogari të kompanisë Lexmark. Aktmarrëveshja e lidhur mes Infolex S.A. dhe ITD SHPK vërteton, se ITD SHPK është distributor i autorizuar i Lexmark për territorin e Shqipërisë. Si distributor i autorizuar i Lexmark, ITD SHPK ka lëshuar autorizimin nr.40 prot., datë 29.08.2023, për InfoSoft Systems SHPK. KPP gjykon, se me qëllim vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të ofertave të paraqitura, autoriteti kontraktor mund të kërkojë sqarime nga operatorët ekonomik ofertesues. Komisioni konstaton, se autoriteti kontraktor gjatë vlerësimit, nuk ka pasqyruar asnjë informacion nëse i ka kërkuar apo jo informacion apo sqarim operatorit ekonomik ankimues lidhur me këtë dokumentacion të paraqitur prej tij, në përputhje me pikën 1, të nenit 92 të LPP. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me dokumentacionin e paraqitur operatorit ekonomik ankimues arrin të provojë përmbushjen e kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të dokumenteve të tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Systems” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: *Nuk plotëson pikën 2.3.6. Për Integrimin e platformës së menaxhimit në distancë të kompjuterëve dhe palmarëve me platformën e menaxhimit në Cloud, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton integrimin e tyre. Nuk ka paraqitur vërtetim nga prodhuesi për integrimin e platformës Manage Engine Endpoint Central Cloud + Service Desk Plus + Mobile Device Manager Plus*, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se,

III.3.1. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.6.e tyre, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.6. Për Integrimin e platformës së menaxhimit në distancë të kompjuterëve dhe palmarëve me platformën e menaxhimit ne Cloud, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton integrimin e tyre. Në rast se janë produkte nga prodhues të ndryshëm, ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim nga secili prodhues për integrimin e tyre. Mos paraqitja e vërtetimeve nga prodhuesit është kusht për skualifikim.

Ndërsa në pikën 2.3.3 të kriterëve të veçanta të kualifikimit autoriteti kontraktor ka përcaktuar :

2.3.3 *Operatorët ekonomikë ofertesues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt objekt prokurimi, sipas tabelës së mëposhtme:*

A	B	C	D
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese	Specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve
1	Kompjuter		

2	<i>Printer Multifunkionale</i>		
3	<i>Printer Termik</i>		
4	<i>Printer Traktor</i>		
5	<i>Fotokopje A4 me ngjyra</i>		
6	Palmar		
8	<i>Barcod Reader</i>		

III.3.2. Nga verifikimi i dokumenteve të dorëzuara në SPE, në funksion të artikullit objekt - prokurimi, 6.Palmar, të përcaktuar në pikën 2.3.3.të kriterëve të veçanta të kualifikimit, operatori ekonomik ankimes ka dorëzuar Shtojcën 5, Formulari i specifikimeve teknike, të plotësuar dhe nënshkruar prej tij, ku për këtë artikull ka deklaruar *Palmar- Rugged Handheld TE-573* me specifikimet përkatëse të tij. Në funksion të përmbushjes së kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.6. të dokumenteve të tenderit, për këtë artikull operatori ekonomik “Infosoft Systems” SHPK ka paraqitur:

- Katalogun për artikullin *Palmar- Rugged Handheld TE-573*
- Dokument noterial, vërtetim njësie me origjinalin datë 15.09.2023, me Nr. Rep 8252, bashkëlidhur praktikës noteriale dokumenti anglisht dhe shqip “Deklaratë” lëshuar nga EIA.SRL me përmbajtje: “... Nëpërmjet kësaj deklarohet se platforma e menaxhimit palmar për modelin e produktit palmar TE 573 ka aftësitë për të ekspozuarvhtë dhënat e nevojshme dhe për tu integruar me produktin qendror të menaxhimit të pikës së fundit të motorit”

III.3.3. Neni 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.3.4. Në nenin 40, pika 6 dhe 8 të VKM nr. 285, datë “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

8. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.”

III.3.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e

asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës.

III.3.6. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, vërejmë se autoriteti kontraktor në kriteret e veçanta të kualifikimit ka kërkuar: *“2.3.6. Për Integrimin e platformës së menaxhimit në distancë të kompjuterëve dhe palmarëve me platformën e menaxhimit ne Cloud, ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton integrimin e tyre. Në rast se janë produkte nga prodhues të ndryshëm, ofertuesi duhet të paraqesë vërtetim nga secili prodhues për integrimin e tyre. Mos paraqitja e vërtetimeve nga prodhuesit është kusht për skualifikim.”*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK, konstatohet se ky i fundit, ka paraqitur katalogun për artikullin Palmar- Rugged Handheld TE-573, sipas specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Nga ana tjetër EIA.SRL me dokumentin “Deklaratë” të datës 30.08.2023 shprehet/deklaron se *platforma e menaxhimit palmar për modelin e produktit palmar TE 573 ka aftësitë për të ekspozuar të dhënat e nevojshme dhe për tu integruar me produktin qendror të menaxhimit të pikës së fundit të motorit.* Nisur nga arsyeja e skualifikimit të autoritetit kontraktor *“Nuk ka paraqitur vërtetim nga prodhuesi për integrimin e platformës Manage Engine Endpoint Central Cloud + Service Desk Plus + Mobile Device Manager Plus,”* KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK e plotëson kriterin e sipërcituar. Për më tepër, vetë autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit nuk ka deklaruar platformën e tij dhe dokumentin konkret që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë, në funksion të përmbushjes së kriterit 2.3.6. Madje, nëse është e nevojshme, autoriteti kontraktor, kërkon sqarime nga ofertuesit, të cilat duhet të jenë me shkrim ose të reflektuara në procesverbal, sikurse parashikohet në nenin 82, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar. KPP konstaton, se nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në dosje dhe informacioni i autoritetit kontraktor, nga ana e këtij të fundit nuk janë kërkuar sqarime nga operatori ekonomik. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK me dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, përmbush kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.6 të kriterëve të veçanta të kualifikimit *“Kapaciteti teknik”* të dokumenteve të tenderit.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Systems” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: *Nuk plotëson pikën 2.1.1 Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të zërave që e kanë të domosdoshëm montimin dhe konfigurimin, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:*

- *Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Software për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale.*
- *Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional ITIL (Foundation Certificate in IT Service Management) ose ekuivalente*
- *Të paktën 2 (dy) punonjës të profileve inxhinier elektronik/telekomunikacioni /specialist TIK Për të vërtetuar kriterin e mësipërm, operatori ekonomik duhet të paraqesë*

*diplomat/certifikatat përkatëse të punonjësit si dhe kontratë të vlefshme pune të lidhura midis operatorit ekonomik dhe punonjësit. Nga dokumentat e paraqitura apo formulari i vetëdeklarimi nuk janë paraqitur të dhënat për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për **Software** për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale të ofruar nga OE i cili ka ofruar platformën Menage Engine, ndërkohë punonjësi i deklaruar për të përmbushur këtë kriter është i certifikuar nga një prodhues i një platforme tjetër menaxhimi, konkretisht Certified Proget Engineer,*
Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 7 të modifikuar të dokumenteve standarde të tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.1.1.e tyre, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.1.1. Për të garantuar cilësinë e punës gjatë instalimit / konfigurimit të zërave që e kanë të domosdoshëm montimin dhe konfigurimin, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kërkesat minimale si më poshtë:

- **Të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për Software për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale ose ekuivalente.**
 - Të paktën 1 (një) punonjës të certifikuar në nivel profesional ITIL (Foundation Certificate in IT Service Managment) ose ekuivalente
 - Të paktën 2 (dy) punonjës të profileve inxhinier elektronik/telekomunikacioni /specialist TIK

Për të vërtetuar kriterin e mësipërm, operatori ekonomik duhet të paraqesë diplomat/certifikatat përkatëse të punonjësit si dhe kontratë të vlefshme pune të lidhura midis operatorit ekonomik dhe punonjësit.

Punonjësi duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me operatorin ekonomik, e vërtetuar kjo me formularët E-sig të listë pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore për muajin e fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, të konfirmuar pranë organeve tatimore.

Certifikatat e punonjësit që mund të jenë në gjuhë të huaj, duhet të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen.

Shënim: *Një punonjës mund të ketë me shumë se një certifikim.*

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 8.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

III.4.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK, si dhe informacionit të dhënë nga autoriteti kontraktor në përmbushje të kriterit të mësipërm, rezulton se operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK ka paraqitur në SPE dokumentacionin me emërtimin:

- Formularin e vetëdeklarimit, ku në Pjesën III, pika B, “Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme” në rubrikën “Profili i punonjësve” ka deklaruar: *1. Specialist të certifikuar për Software për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale. - A. Shkumbini*
2. Punonjës të certifikuar në nivel profesional ITIL - J. Dhamo; E. Dako

3. Punonjës të profileve inxhinier elektronik/telekomunikacioni /specialist TIK. -Q.Gazidede; K.Milo; E.Cene

III.4.3. Në nenin 77 , pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

III.4.4. Në nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti ose enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë:

- a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit kontraktor duhet të jenë në origjinal ose kopje të noterizuara të tyre;
- b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna. Rregulla të posaçme për këtë pikë parashikohen në rregullat e prokurimit publik.

III.4.5. Në nenin 92 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë

të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit”.

III.4.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 dhe gërma “i” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

III.4.7. Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” pika 3 dhe 5, e Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “...3.Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”...

5. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

III.4.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.9. Në rastin konkret, nisur nga arsyeja e skualifikimi të operatorit ekonomik ankimues se: *“...Nga dokumentet e paraqitura apo formulari i vetëdeklarimi nuk janë paraqitur të dhënat për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar në nivelin profesional nga prodhuesi për **Software** për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale të ofruar nga OE i cili ka ofruar platformën Menage Engine, nderkohë punonjësi i deklaruar për të përmbushur këtë kriter është i certifikuar nga një prodhues i një platforme tjetër menaxhimi, konkretisht Certified Proget Engineer...“*, Komisioni gjykon, se në fazën e vlerësimit procedural në të cilën ndodhet aktualisht procedura e prokurimit objekt-ankimi, për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor/enti kontraktor të cilat shërbejnë si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike (SPE), operatori ekonomik “Infosoft Systems” SHPK, ka dorëzuar Formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, të firmosur dhe vulosur prej tij, ku në Pjesën III, pika B, “Për disponimin e punonjësve dhe makuinerive të nevojshme” në rubrikën “Profili i punonjësve” ka deklaruar: *1. Specialist të certifikuar për Softëare për*

monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale. - A. Sh. 2. Punonjes te certifikuar në nivel profesional ITIL - J. Dh.; E. Dako 3. Punonjës të profileve inxhinier elektronik/telekomunikacioni /specialist TIK. -Q.G.; K.M; E.C.

Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se deklarimi i specialistit të certifikuar për *Software* për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, në stadin në të cilin ndodhet procedura e vlerësimit, sjell edhe përmbushjen e kriterit të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit lidhur me disponimin e një specialisti të certifikuar për *Software* për monitorimin dhe menaxhimin e platformes virtuale. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit në këtë fazë, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Systems” SHPK qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “InfoSoft Systems” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së tij me arsyen se: “5. Nuk plotëson pikën 2.3.3. për pajisjet Barkode reader . Referuar katalogut të paraqitur Pajisja e ofertuar BARCODE YES Blaster 2R nuk plotëson specifikimin: Program i përfshirë Po, program që të gjenerojë të dhëna të skanimeve si dhe raporte, mundësi për të programuar skanerin si dhe upgrade të *firmware*.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve standarde të tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, pika 2.3.3.dhe 2.3.4. e tyre, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

2.3.3 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt objekt prokurimi, sipas tabelës së mëposhtme:

A	B	C	D
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese	Specifikimet teknike referuar katalogëve/prospekteve
1	Kompjuter		
2	Printer Multifuksionale		
3	Printer Termik		
4	Printer Traktor		
5	Fotokopje A4 me ngjyra		
6	Palmar		
8	Barcod Reader		

Konkretisht në kolonën **D**, të skedës teknike, operatorët ekonomikë duhet të japin një përshkrim të plotë të karakteristikave teknike për artikujt e specifikuar, karakteristika këto që

duhet të përputhen me specififikimet teknike të kërkuara. (Numrat rendor i referohen numrave të artikujve sipas tabelës në shtojcën 6 "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit".)

2.3.4. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin katalogët/prospektet e prodhuesit për të gjithë artikujt e përfshirë në **skedën teknike**.

III.5.2. Nga shqyrtimi i dokumenteve të dorëzuara në SPE, në funksion të artikullit objekt - prokurimi, 8. *Barcod Reader*, të përcaktuar në pikën 2.3.3. të kriterëve të veçanta të kualifikimit, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar Shtojcën 5, Formulari i specififikimeve teknike, të plotësuar dhe nënshkruar prej tij, ku për këtë artikull ka deklaruar *Barcode Reader -Blaster -2R* me specififikimet përkatëse të tij. Në funksion të përmbushjes së kriterit të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.4. të dokumenteve të tenderit, për këtë artikull operatori ekonomik "Infosoft Systems" SHPK ka paraqitur Katalogun e produktit *Barcode Reader -Blaster -2R*.

III.5.3. Neni 2 "Qëllimi i ligjit" 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikon se: "Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik".

Ndërkohe në nenin 3 "Parime të përgjithshme" 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: "1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën".

Në pikat 1 dhe 4 të nenit 77 "Kërkesat për kualifikim" të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" parashikohet shprehimisht se:

"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.5.4. Në nenin 40 pika 1, 2 dhe 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimit të mallrave.

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

3. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.5.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se

operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike të produkteve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e specifikimeve të mallrave/shërbimeve të ofertuara prej tyre me ato të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me specifikimet përkatëse të kërkuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi

III.5.6. Referuar sa më sipër, Komisioni konstaton, se në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar në pikën 2.3.4, kapaciteti teknik, dokumentet që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë pjesëmarrës, katalogët e prodhuesit për të gjithë artikujt objekt - prokurimi. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor e përcaktuar në pikën 2.3.4 kapaciteti teknik i dokumenteve standarde të tenderit është një kërkesë e ligjshme e në përputhje me gërmën “b”, të pikës 6 të nenit 40 të VKM 285/2021. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pika 2.3.4, kapaciteti teknik, KPP konstaton, se ky i fundit, ka dorëzuar katalogun *Blaster 2R* për produktin objekt - prokurimi *Barcode Reader*. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik si pjesë të ofertës së tij ka dorëzuar dokumentacion e kërkuar në dokumentet standarde të tenderit për produktin që ka ofruar. Nga verifikimi i bërë këtij katalogu me specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor për këtë produkt, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik përmbush kriterin e parashikuar në pikën 2.3.3, pasi të dhënat (specifikimet teknike) e pasqyruara në këtë katalog janë në përputhje me specifikimet teknike të artikullit të kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK ndaj vendimit të KVO-së për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Elektronik” SHPK dhe mënyrës së vlerësimit të ofertave të operatorëve të tjerë ekonomikë, sa i përket mënyrës së paraqitjes së sigurimit të ofertës nga ana e tyre në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e operatorit ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK nuk pranohen të gjitha, pra ai nuk përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP-së nuk do të ndryshojë, pra do të mbetet i skualifikuar, trajtimi i pretendimeve të tij në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “BNT Elektronik” SHPK dhe mënyrës së vlerësimit të ofertave të operatorëve të tjerë ekonomikë, nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka se si të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën

që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të shpallej fitues i kontratës objekt-prokurimi, duke qenë se ai qëndron i skualifikuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-76141-07-26-2023 me objekt “Blerje pajisje Informatike (Kompjuter, Printer multifunksional, Printer termik, Printer traktor, Fotokopje A4 me ngjyra, Palmar, Monitor televizori, Barcod Reader)”, me fond limit 70,000,000 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 18.09.2023 nga autoriteti kontraktor Sh.A Posta Shqiptare.
2. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “InfoSoft Systems” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

